**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Nr.** 6950 **Rep.**
**Nr.** 1384 **kol.**

# KONTRATE SHITJE

# TE KUOTAVE TE KAPITALIT

Ne qytetin e Tiranes, sot me daten 15.11.2006, para meje noterit Eqerem Gaxholli, prane dhomes se notereve Tirane, u paraqiten personalisht palet si me poshte vijon:

**I.-PALA SHITESE.**

**Arjan Astrit Leskaj**, i datelindjes 11.04.1968, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "Gjergj Fishta", pallati 5 Ap.64, i martuar me aresim te larte, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes me **Nr.0012578,**

**II.-PALA BLERESE.**

**Gjergji Hoxha**, i biri i Nevruzit dhe i Adiles, i datelindjes 05.10.1965, lindur ne Korçe dhe banues ne Tirane, Rruga "Asim Vokshi" pallati 49/1, shkalla 1, ap.40, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes me **Nr. Z 0189297**,

Pasi verifikova statusin juridik te paleve te mesiperm une NOTERI konstatova se palet, jane madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe me vullnetin e tyre te lire e te plote me kerkuan dhe rane dakord me redaktimin e kesaj **Kontrate Shtiblerje Kuotash te Kapitalit Themeltar TE SHOQERISE "ARAMERAS" SH.P.K.,** duke u mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar sipas kushteve dhe afateve qe vijojne me poshte:

**Neni 1**
**"TE DHENAT PARAPRAKE"**

Shoqeria "Arameras"Sh.P.K. eshte rregjistruar si person juridik Shqiptare, me vendimin Nr.11201/2 date 19.12.2006, te rrethit Gjyqesore Tirane, ne te cilen marrin pjese si bashkepronare, 7(shtate) ortake, qe jane: zoterinjet, Arben Dervishaj, Luan Duraj, Anthim Vjero, Artan Dulaku, Petraq Koka dhe Maksim Muçi, te cilet zoterojne ne pjese te

barabarta, nga **12.5 %** te Kontributeve ne kapitalin themelore te kesaj Shoqerie, ose nga **12,5** te kuotave te saja dhe ortaku tjeter zoti, Arjan Leskaj qe zoteron **25 %** te kontrubiteve ne kapitalin themelor, ose **25** kuota te shoqerise "Arameras" Sh.p.k.

Kapitali themelor i kesaj shoqerie eshte **100.000** (nje qind mije) leke, e ndare ne **100** (njeqind) kuota, me vlere **1000**(nje mije) leke sejcila.

**Neni 2**
**"Objekti i Kontrates"**

Me ane te kesaj kontrate shitjeje te kuotave te kapitalit themelore, **pala shitese**, qe zoteron **25 %** (njezet e pese %) te kontributeve ne kapitalin themelor, ose **25** (njezet e pese ) kuota, ne Shoqerine "Arameras" Sh.P.K. me deshiren e tij dhe me kerkesen e bleresit, duke marre me pare edhe mendimin e te gjithe ortakeve te tjere te kesaj Shoqerie, i shet dhe ia transferon **pales blerese 12.5%** te kontributit ne kapitalin themelore, ose **12.5** kuota te te gjithe kapitalit te Shoqerise "Arameras" Sh.P.K.

**Neni 3**
**"Çmimi i Shitjes dhe Menyra e Pagimit"**

**3.1-Shitesi,** qe zoteron **25%** te pjeseve te kontributeve ne kapitalin themelor, ose **25** kuota te Shoqerise "Arameras" Sh.P.K. **i shet (transferon) 12.5 kuota** tek bleresi, i cili pranon t'i blejne ato, kundrejt çmimit prej **1000** (nje mije) leke per kuote. Shuma e pergjitheshme e **12.5** kuota eshte **12.500**(dymbedhjete mije e peseqind) leke, te cilat jane paguar nga bleresi jashte kesaj zyre.

**3.2-Shitesi dhe Bleresi** nuk kane asnje pretendim te tashem apo te ardheshem mbi keto vlera, per te cilen shitesi dhe bleresi deklarojne se jane likujduar totalisht jashte zyres se noterise.

**Neni 4**
**"Kalimi i Pronesise"**

**4.1**-Qe nga momenti i nenshkrimit te kontrates, **bleresi**, si ortak i Shoqerise "Arameras" Sh.P.K. zoteron ne pronesine e tij, **12.5 %** te kontributeve ne kapitalin themelore, ose **12.5** kuota te kesaj shoqerie, ndersa shitesi zoteron ne pronesine e tij **12.5 %** te kontributeve ne kapitalin themelor, ose **12.5 %** te kuotave te kesaj shoqerie.

**4.2**-Shoqeria **"Arameras" Sh.P.K.** me neshkrimin e kesaj kontrate, do te behet me **8 (tete)** ortake, me zoterinjet, **Arben Dervishaj, Luan Duraj, Anthim Vjero, Artan Dulaku, Petraq Koka , Maksim**

**Muçi, Arjan Leskaj dhe Gjergji Hoxha,** te cileve u takojne ne menyre te barabarte nga **12.5%,** pjese te kontributeve ne kapitalin themeltare, ose nga 12.5 kuota per gjithesjecilin ortak.

**Neni 5**
**"Mendimi i Ortakeve"**

Per arritjen e marreveshjes se me siperme per shitjen e kuotave dhe pranimin e nje ortaku te ri ne Shoqerine "Arameras" Sh.p.k. eshte marre mendimi i te gjithe ortakeve, me ane te Vendimit me Nr. 3 date ____._____.2006.

**Neni 6**
**"Baza Ligjore"**

Kjo kontrate do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperi dhe ligjit Nr.7638 date 19.12.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin Tregtar".

Kjo kontrate do te detyroje palet dhe do te jete vlefshme midis tyre, ashtu dhe per trashigimtaret ligjore te tyre.

**Neni 7**
**"Hartimi i Kontrates"**

Kjo kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe ne **5** (pese) kopje te barasvlefshme dhe perbehet nga **4** flete sejcila. Çdo njera prej tyre ka permbajtje te njejte ligjore dhe sejcila pale do te mbaje nga nje kopjo. Dy kopjo te tjera, njera mbahet nga noteri dhe tjetra do te depozitohet ne zyren e Regjistrimit te Shoqerive Tregtare.

**Neni 8**
**"Hyrja ne Fuqi e Kontrates"**

Te gjitha detyrimet dhe te drejtat qe burojne nga kjo Kontrate fillojne efektet e tyre nga momenti i neshkrimit te saj.

Kjo kontrate anullon çdo marreveshje te me pareshme me shkrim apo me goje.

Une noteri, pasi e lexova me ze te larte paleve teksin e kesaj kontrate te hartuar ne pese kojpo, dhe palet me deklaruan se e kuptojne dhe e pranojne, konstatova se ata e gjejne kontraten, te rregullt ne

perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe une Noteri i vertetoj neshkrimet e tyre sipas ligjit.

## PALET KONTRAKTORE

| PALA SHITESE | PALA BLERESE |
| --- | --- |
| Arjan LESKAJ | Gjergji HOXHA |

**N O T E R I**
**Eqerem GAXHOLLI**